



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 25/08/2025

PROCES VERBAL

Konsultimi Publik për Strategjinë e Planit të Veprimit të Turizmit 2025-2030

Vendi : Qendra Multifunktionale, Përmet

Ora : 19:00

Tema e konsultimit : Strategjia e Planit të Veprimit të Turizmit 2025-2030

I mbajtur sot më datë 25 Gusht, pranë ambienteve të Qendrës Multifunktionale. Të pranishëm në këtë konsultim ishin Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha, Zv/Kryetarja znj. Aulona Meshini, drejtorët e sektorëve dhe pjesëtarë të tjerë të administratës së bashkisë, Këshillit Bashkiak, biznese, operaatorë dhe guida turistike, komunitet dhe OJF që veprojnë në Përmet.

Takimi u hap nga Kryetarja e Bashkisë e cila fillimisht përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Më pas ajo theksoi se është bërë një punë voluminoze për të arritur deri tek ky dokument final që do të prezantohet ditën e sotme. Gjithashtu u përmend se në përgatitjen e këtij dokumenti kanë dhënë kontributin e tyre ekspertë të fushës së turizmit pjesë e projektit që një nga shoqatat po zbaton në Përmet. Në vijim të fjalës së saj Kryetarja e Bashkisë tregoi edhe një herë se këto takime konsultuese janë mjaft të rëndësishme në miratimin e dokumenteve me rëndësi për qytetin dhe se pjesëmarrja dhe sugjerimet e çdo aktori janë të rëndësishme për të ardhmen e turizmit dhe të mirat e përbashkëta që vijnë nga prioritetet e përcaktuara në Plan. Në përfundim ajo u shpreh e gatshme të dëgjonte ide dhe sugjerime të ardhura nga biznesi, operatorët turistikë si dhe qytetarë të Përmetit jo vetëm nga takimi por edhe mundësia nëpërmjet pyetësorit online të publikuar në rrjetet e bashkisë dhe faqen zyrtare të saj.

Linku pyetësorit : <https://forms.gle/E7iqAËQzyE8p5LsBA>

Më pas fjalën e mori Zv/Kryetarja e Bashkisë Përmet znj. Aulona Meshini e cila gjithashtu shprehu falenderime për të pranishmit por edhe për grupin e punës së përfshirë në hartimin e këtij dokumenti me një rëndësi të vecantë për vijueshmërinë e turizmit në qytetin tonë.

Gjithashtu znj. Meshini tregoi se janë kryer një sërë takimesh brenda institucionit të Bashkisë për të ndërtuar një plan sa më efikas dhe të detajuar. Takimi vazhdoi duke prezantuar më në hollësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

në atë cka përmban ky plan, objektivat e tij, veprimtaritë që parashikohen të zhvillohen e të tjera me rradhë.

Pasi përfundoi prezantimi i Planit të Veprimit të Turizmit 2025-2030, fjala iu dha menjëherë pjesëmarrësve. Disa nga pyetjet dhe sugjerimet e dala nga ky konsultim janë :

- Si do të veprohet me menaxhimin e hapësirave publike ?
- Si do të menaxhohen Banjat e Bënjës pas përfundimit të investimit që aktualisht po zbatohet?
- Cfarë synojmë të arrijmë në vitin 2030 ?
- Si do të arrijmë të rrisim kohëzgjatjen e qëndrimit të vizitorëve ?
- Të rriten shërbimet në fushën e turizmit.
- Të krijojmë një strategji ambicioze dhe me objektiva të qartë.
- Të ruajmë tipologjinë e turizmit aktual.
- Mbrojtja e mjedisit të zgjerohet në zonat rurale si një ndër elementet kryesore për turizëm cilësor.

Drafti do të vijojë të qëndrojë I publikuar në faqen zyrtare të bashkisë :

<https://bashkiapermet.gov.al/ep-content/uploads/2025/08/PLANI-i-Turizmit-4.pdf> duke mirëpritur për ditët në vijim sugjerime dhe rekomandime nga grupet e interesit dhe më pas reflektimi I tyre në Plan përpara miratimit në Këshillin Bashkiak.

Takimi u mbyll më **20:15**.

Konceptoi: Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:

